



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

USTAVNI SUD

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 maj 2023

Nr.ref.:RK 2196/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI156/22

Parashtrues

“Thermo SHPK”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit E. Rev. 04/2021 të Gjykatës
Supreme të 5 majit 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përberë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga “Thermo SHPK” (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), përfaqësuar nga Osman Havolli, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [E.Rev.04/2021] të 5 majit 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 17 qershor 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [E.Rev.04/2021] të 5 majit 2022 të Gjykatës Supreme përmes të cilit sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në ndërlidhje me nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 14 tetor 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 26 tetor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI156/22] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 31 tetor 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Komerciale në Prishtinë dhe kësaj të fundit iu kërkua që të dorëzojë dëshminë (fletë-kthesën) që tregon datën kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar vendimin e kontestuar.
9. Më 3 nëntor 2022, Gjykata Komerciale dorëzoi fletë-kthesën që tregon datën kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme
10. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
11. Më 16 shkurt 2023, Gjykata kërkoi nga Gjykata Komerciale që të dorëzojë dosjen e plotë të lëndës.
12. Më 20 shkurt 2023, Gjykata Komerciale dorëzoi dosjen e plotë lëndës.

13. Më 12 prill 2023, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

14. Nga shkresat e lëndës rezultojnë se ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe palës së paditur bankës “TEB” me seli në Prishtinë ka lindur një mosmarrëveshje për një shumë të caktuar të të hollave që gabimisht i janë dërguar palës së tretë e cila nuk i kishte kthyer të hollat e transferuara. Duke qenë se pala e paditur banka “TEB” nuk kishte pranuar përgjegjësinë për transferin e gabuar të të hollave, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi për kompensim për shumën e të hollave të dërguara gabimisht palës së tretë.
15. Më 6 shkurt 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [IV.EK.C.nr.349/14] vendosi: (i) **MIRATOHET** kërkesëpadija e parashtruesit të kërkesës të ushtruar kundër të paditurit banka “TEB” sh.a., ashtu që detyrohet i padituri që parashtruesit të kërkesës t’ia paguaj 55.000.00 euro, me kamatë ligjore në lartësi prej 8 %, duke llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë më 13.06.2014, deri në pagesën definitive të borxhit në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga pala e paditur, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.; (ii) secila palë në këtë çështje kontestuese do t’i paguaj shpenzimet e veta kontestimore.
16. Gjykata Themelore, mes tjerash, arsyetoi: (i) gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave si në shkresat e lëndës, gjeti se kërkesëpadija e parashtruesit është e bazuar, duke arsyetuar se parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij F.H., ka shkuar në bankën “TEB” në Prishtinë dhe ka kërkuar që shumën prej 55,000.00 euro, të transferoj në emër të “M.T.,Doo”, sipas pro-faturës që ia ka parashtruar bankës me nr.04/14 e datës 22.01.2014; (ii) zyrtarët e të paditurit nuk kanë mundur të bëjnë transferin, për arsye se përfituesi e ka ndërruar konton dhe zyrtari i të paditurit e ka thirrur parashtruesin e kërkesës që sërish të vijë në bankë dhe të plotëson urdhër transferin e ri nr.293871, të datës 22.02.2014, të cilin e ka plotësuar zyrtari i i të paditurit A.K., ndërsa përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës F.H e nënshkruan urdhërpagesën dhe mjetet në shumë prej 55,000.00 euro, transferohen gabimisht në llogarinë e firmës “L.M. Doo” e cila nuk i ka kthyer parat; (iii) sipas ekspertizës financiare të punuar nga Sh.M., rezultojnë se zyrtari i të paditurit i ka keqpërdorur mjetet e besuara të parashtruesit të kërkesës duke bërë transferin gabimisht, e po ashtu nga mendimi dhe konstatimi i grupit të ekspertëve financiar rezultojnë se zyrtari i të paditurit nuk është bazuar në dokumentet e ofruara nga parashtruesi i kërkesës; (iv), andaj i padituri me këto veprime ka dëmtuar parashtruesin e kërkesës dhe; (v) mbi këto arsye është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 154.1 dhe nenin 382.1 të LMD-së si dhe nenin 143 të LPK-së.
17. Më 8 mars 2019, pala e paditur paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që të aprovoj ankesën e të paditurit ndërsa aktgjykimin e atakuar ta prish në tërësi. Parashtruesi i kërkesës ishte përgjegjës ndaj ankesës duke propozuar që padia e palës së paditur të refuzohet e pabazuar dhe aktgjykimi ankimor të vërtetohet.
18. Më 17 maj 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ae.nr.119/19] e hodhi poshtë të palejueshme ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [IV.EK.C.nr.349/14] të datës 06.02.2019.

19. Gjykata e Apelit kishte konstatuar se padia e palës së paditur ishte e paafatshme duke arsyetuar: *“Gjykata e Apelit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, konstatoi se e paditura e ka pranuar aktgjykimin e atakuar me datën 01/03/2019, ndërsa ankesën e ka dorëzuar me datën 09/03/2019, që nënkupton se ankesa është parashtruar pas kalimit të afatit ligjor të parapare me nenin 509 pika c) e LPK-së, që është përcaktuar se: “kundër aktgjykimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, palët mund të bëjnë ankim brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, andaj Gjykata e Apelit duke u bazuar në nenin 186 Shënim paragrafi 2 të LPK-së, sipas të cilit ankesa është e paafatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj, si dhe nenit 196 të LPK-së, ku është përcaktuar se: ankesën e vonuar, jo të plotë, apo të palejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç është parashikuar në nenin 186 të LPK-së.”*
20. Më 7 qershor 2019, pala e paditur TEB bazuar në nenet 232 g), 234, 235 dhe 236 të LPK-së paraqiti Propozim për Përsëritje të Procedurës në Gjykatën e Apelit. Pala e paditur TEB kishte theksuar se Gjykata e Apelit gabimisht ka kualifikuar paafatshmërinë e ankesës së saj sepse ankesa në “realitet” është dorëzuar më 08.03.2019 dhe jo më 09.03.2019 siç gabimisht ka konstatuar Gjykata e Apelit me Aktvendimin [Ae.nr.119/2019] të datës 17.05.2019. Pala e paditur TEB ne Propozim për Përsëritje të Procedurës në Gjykatën e Apelit kishte propozuar: (i) APROVOHET si i bazuar propozimi për përsëritjen e procedurës i të paditurës TEB dhe (ii) ANULOHET Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ae.nr.119/19] i datës 17.05.2019 dhe lënda i KTHEHET në rigjykim Gjykatë së Apelit.
21. Më 12 qershor 2019, pala e paditur TEB bazuar në nenet 129 dhe 130 paragrafët 1 dhe 2 të LPK-së paraqiti Propozim për Kthim në Gjendje të Mëparshme në Gjykatën e Apelit. Pala e paditur TEB kishte theksuar se Gjykata e Apelit gabimisht ka kualifikuar paafatshmërinë e ankesës së saj sepse ankesa në “realitet” është dorëzuar më 08.03.2019 dhe jo më 09.03.2019 siç gabimisht ka konstatuar Gjykata e Apelit me Aktvendimin [Ae.nr.119/2019] të datës 17.05.2019. Pala e paditur TEB kishte propozuar: (i) APROVOHET si i bazuar Propozimi për Kthim në Gjendjen e Mëparshme i të paditurës TEB; (ii) ANULOHET Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ae.nr.119/19] i datës 17.05.2019 dhe që Gjykata e Apelit të VENDOS më mënyrë Meritore në lidhje me Ankesën e të paditurës TEB të ushtruar më 08.03.2019 kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [IV.EK.C.nr.349/14] të datës 06.02.2019.
22. Më 18 tetor 2019, Gjykata e Apelit me trup gjykues prej tre gjyqtarësh përmes Aktvendimit [Ae.nr.336/19] e refuzoi të pabazuar propozimin e palës së paditur për kthim në gjendjen e mëparshme, me kërkesë që të anulohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ae.nr.119/ 19] i datës 17.05.2019 si dhe Gjykata e Apelit të vendos ne mënyrë meritore ne lidhje me ankesën e të paditurës të ushtruar me datën 08.03.2019, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore [IV.EK.C.nr.349/144] i datës 06.02.2019, si dhe të obligohet parashtruesi i kërkesës t'i bart të gjitha shpenzimet procedurale.
23. Gjykata e Apelit kishte arsyetuar: *“Kolegji i Gjykatës së Apelit, pas vlerësimit dhe shqyrtimit të kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme e në raport me shkresat e lëndës, ka gjetur se propozimi i tillë është i pa bazuar, për arsye se instituti i kthimit në gjendjen e mëparshme është që palës t'i lejohet që të ndërmarr një veprim procedural, të cilin nuk e ka ndërmarr brenda afatit të caktuar, ndërsa në rastin konkret dhe duke u bazuar në vërtetimin e Postës së Kosovës Nr.05-1182/19 e datës 31/05/2019, rezulton se e paditura ankesën e ka paraqitur me datën 08/03/2019 ndërsa Posta e Kosovës e ka vulosur dërgesën postare me datën 09/03/2019, që nënkupton se ankesa është paraqitur nga e paditura brenda afatit të parapare ligjor,*

megjithatë kjo provë e prezantuar ne propozimin për kthimin ne gjendjen e mëparshme mund të shërbej në procedurën sipas mjeteve juridike të jashtëzakonshme. Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 129 e lidhur me nenin 133.4 të LPK-se, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.”

24. Më 21 tetor 2019, Gjykata e Apelit me trup gjykues prej një gjyqtar individual përmes Aktvendimit [EN.nr.7/19] e lejoi përsëritjen e procedurës sipas propozimit të palës së paditur TEB dhe anuloi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ae.nr.119/19] të datës 17.05.2019.
25. Gjykata e Apelit arsyetoi: (i) pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe në pajtim me dispozitat e nenit 239.1 të LPK-së propozimi për përsëritje të procedurës është i lejuar; (ii) propozimi për përsëritje të procedurës është paraqitur brenda afatit ligjor në pajtim me nenin 243.3 të LPK-së; (iii) pala e paditur ka dorëzuar dërgesën postare më 08.03.2019 çka dëshmohet edhe përmes Librit të pranimit të datës 08.03.2019, por pasi ka qenë fundi i orarit i zyrës postare dërgesa është vulosur të nesërmen në mëngjes me datë 09.03.2019; (iv) bazuar në konfirmimin zyrtar nga Posta e Kosovës rezulton se ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor prej shtatë (7) ditësh dhe nuk mund të konsiderohet më tutje si e paafatshme; (v) neni 32 i kushtetutës nënkupton të drejtën e secilit që të parashtojë ankesë ose mjete tjera juridike kundër akteve të veçanta juridike të nxjerra në procedurën në shkallë të parë gjykatës, organit të administratës ose organizatës dhe institucioneve të tjera që ushtrojnë autorizim publik; (vi) shfrytëzimi i mjeteve juridike është një mundësi e mirë që edhe njëherë autoritetet publike shtetërore t'i shqyrtojnë vendimet e tyre, t'i përmirësojnë gabimet ose lëshimet eventuale, që kanë mundur të ndodhin gjatë procedurave të ndryshme; (vii) në një gjendje të tillë të çështjes, pala propozuese nuk ka pasur mjet tjetër të efektshëm ligjor përveç mjetit juridik përsëritja e procedurës dhe për këto arsye miratohet propozimi duke lejuar që procedura e përfunduar me aktvendimin e formës se prerë të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.119/19 i datës 17.05.2019, të përsëritet dhe çështja në shqyrtim duhet që t'i dërgohet kolegjit që ankesa të trajtohet më tutje në përmbajtjen dhe themelësinë e saj; (viii) përsëritja e procedurës në këtë çështje mundëson parandalimin e padrejtësive, ofron vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj, rritë sigurinë juridike për palët dhe garanton parimin e sundimit të ligjit; (ix) nga sa u tha më sipër e bazuar në dispozitat e nenit 32 dhe 102 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 234 paragrafi 1 pika g) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.
26. Më 16 shtator 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ae.nr.341/19] vendosi: (i) **APROVOHET** e themeltë ankesa e të paditurit Banka “TEB” dhe **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë [IV.EKC.nr.349/14] i datës 06.02.2019 dhe gjykohet si vijon: Refuzohet në tërësi kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Banka “TEB” me seli në Prishtinë, që t'ia paguaj parashtruesit të kërkesës shumën prej 55,000.00 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë, përkatësisht data 13.06.2014 e deri në pagesën definitive të këtij borxhi në emër të kompensimit të demit të shkaktuar nga pala e paditur, parashtruesit të kërkesës në afat paritiv prej shtatë (7) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.
27. Gjykata e Apelit arsyetoi: “Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke arsyetuar se paditësi përmes përfaqësuesit të tij F.H., ka shkruar në bankën “TEB” në Prishtinë dhe ka kërkuar që shumën prej 55,000.00 euro të transferoj në emër të M.T.Doo, sipas pro-faturës që ia ka parashtruar bankës me

nr.04/14 e datës 22/01/2014. Zyrtaret e të paditurit nuk kanë mundur të bëjnë transferin, për arsye se përfituesi e ka ndërruar konton dhe zyrtari i të paditurit e ka thirrur paditësin që sërish të vijë në bankë dhe të plotëson urdhër transferin e ri nr.293871 të datës 22/02/2014 të cilën e ka plotësuar zyrtari i paditëses A.K., ndërsa përfaqësuesi i paditësit e nënshkruan urdhërpagesën dhe mjetet në shume prej 55,000.00 euro transferohen gabimisht në llogarinë e firmës "L.M. Doo" e cila nuk i ka kthyer paratë. Sipas ekspertizës financiare të punuar nga Sh.M., rezultoi se zyrtari i të paditurit i ka keqpërdorur mjetet e besuara të paditësit. Nga një gjendje e tillë faktike e konstatuar dhe vërtetuar, i themeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka aplikuar të drejtën materiale, pasi që për t'u plotësuar kushti ligjor i parapare me nenin 154 të LMD-së, me të cilën dispozitë shprehimisht përcaktohet: Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij, domosdoshmërisht duhen të plotësohen këto parakushte: Të ekzistojnë subjektet e marrëdhënieve detyrimore dhe të përgjegjësive për dëmin e shkaktuar respektivisht duhet të ekzistoj shkaktuesi i dëmit dhe i dëmtuari, të ekzistoj fakti dëmtues, nga rrjedh dëmi, të ekzistoj dëmi i shkaktuar, të ekzistoj lidhja shkakësore ndërmjet faktit dëmtues dhe dëmit të shkaktuar si dhe të ekzistoj kundërligjshmëria e veprimit, përkatësisht e mosveprimit nga është shkaktuar dëmi, të cilat kushte duhen të plotësohen në mënyrë kumulative. Në rastin konkret me provat e administruara, nuk është vërtetuar përgjegjësia e të paditurës për dëmin e shkaktuar mbi bazën e fajësisë."

28. Parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i shkallës së dytë të ndryshohet dhe të mbetet në fuqi aktgjykimi i shkallës së parë. Po ashtu edhe kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [EN.nr.7/19] i datës 21.10.2019 të anulohet dhe të mbetet në fuqi Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ae.nr.119/19] i datës 7.05.2019.
29. Më 5 maj 2022, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E.Rev.nr.4/2021] vendosi: **REFUZOHET** i pabazuar revizioni i parashtruesit të kërkesës i paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ae.nr.341/19] të datës 16.09.2020; **HEDHET** e palejuar revizioni i parashtruesit të kërkesës i paraqitur kundër Aktvendimit [EN.n.7/19] të datës 21.10.2019.
30. Gjykata Supreme arsyetoi: (i) Gjykata Supreme e hodhi të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [EN.n.7/19] të datës 21.10.2019, kjo për faktin se revizioni i është ushtruar kundër aktvendimit kundër të cilit nuk lejohet revizioni e as mjeteve të rregullt juridik, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 240.3 të LPK-së, ku përcaktohet "Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin aprovohet propozimi për përsëritjen e procedurës nuk lejohet ankimi"; (ii) po ashtu pretendimi në revizion lidhur me atë se ekziston përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit, për shkak të papërgjegjësive së punëtorit të paditurës, është i pa bazë, nga akti i brendshëm i të paditurës, i quajtur Kushtet e Përgjithshme të paditurës, në nenin 6 par.2, me të cilën është përcaktuar: "Është përgjegjësi e klientit të kontrollojë saktësinë e të gjithë numrave, detajeve dhe informatave mbi format dhe udhëzimet, përfshirë por jo kufizuar në transfere dhe formularë për taksa"; (iii) andaj ky pretendim se punonjësi i të paditurës, nuk kishte vepruar sipas pro faturës nr. 04/14, dt. 20.01.2014, në emër të shitësit - pranuesit të mjeteve "M.T." Doo, është i pa bazë pasi vetë klienti është i detyruar që në rastin e nënshkrimit të urdhër transferit të kontrollojë të dhënat dhe

saktësinë e tyre; (iv) Pro-fatura nr. 041/14, dt. 20.01.2014, në emër të shitësit-pranuesit të mjeteve “M.T.” Doo, nuk përmban xhirollogarinë në të cilin duhet të bëhet pagesa, ndërsa nga dëshmia mbi transaksionet e pagesave të parashtruesit të kërkesës, shihet se pagesa e fundit para transaksionit kontestues, është bërë me datë 23.12.2013, në llogarinë e firmës “L.M. Doo”, që nënkupton se parashtruesi i kërkesës ka pasur transaksione dhe raporte afariste me të dy ndërmarrjet në emër të cilave është bërë pagesa; (v) punonjësi i të paditurës e ka përmbushur obligimin e tij ndaj klientit me ofrimin për nënshkrim të urdhërpagesës, siç është i përkufizuar në nenin 33 par. 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 04/L-155 për sistemin e pagesave, ku është përcaktuar: “1.Një transfer i fondeve konsiderohet i autorizuar vetëm nëse dërguesi ka dhënë miratim për ekzekutimin e një transferi të tillë. 2. Miratimi për ekzekutimin e një transferi të fondeve apo të një serie të transfereve jepet në formën e dakorduar nga palët”; (vi) ndërsa nëse marrim parasysh nenin 6 par.2, të kushteve të përgjithshme të paditurës, në asnjë mënyrë nuk paraqet bazë për krijimin e detyrimit të paditurës në raport me parashtruesin e kërkesës;(vii) pretendimi se papërgjegjësia e të paditurës rezulton edhe me nenin 9 dhe 152, të LMD-së, është pretendim i pa bazuar, pasi në këtë rast punonjësi i të paditurës ka pasur detyrim që paditësit t’i shërbej si klient, sipas kërkesës së tij, duke e kryer shërbimin të cilin e kërkon, pra duke vepruar sipas kërkesës së tij, dhe me vet faktin se formulari i urdhërpagesës është dashur të plotësohet nga vet klienti, i njëjti bart edhe përgjegjësinë për pasaktësinë e të dhënave të shënuara; (viii) sa i përket ekzekutimit detyrimi i të paditurës është përmbushur me vet faktin se paditësi është njoftuar me kushtet e pagesës duke i ofruar për nënshkrim, dhe ky ka qenë sinjal i mjaftueshëm për paditësin që të ndaloj ekzekutimin e pagesës, pasi ka qenë detyrim i tij bëjë vërejtjet mbi pasaktësinë e urdhërpagesës; (ix) Gjykata Supreme vlerëson se ekspertiza e ekspertit financiar Sh.M., dhe grupit të ekspertëve në përbërje V.I., F.K., dhe R.F., nuk kanë asnjë rendësi për të vendosur në këtë çështje, ka qenë plotësisht e pa nevojshme të nxjerrët, për faktin se gjykata ekspertizën e cakton sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes, ndërsa në këtë rast nuk kemi të bëjmë fare me ekspertizë financiare, por përfundimet e këtyre ekspertizave janë konkluzione juridike për të cilat gjykata nuk ka pasur nevojë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) KEDNJ-së.
32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se mjeti i jashtëzakonshëm revizioni i cili ishte në disponim të tij ka rezultuar i paefektshëm “për shkak të zbatimit të gabuar të rregullave, të cilat në vetvete janë të pasakta dhe të paqarta, cenojnë parimet e sigurisë juridike dhe të shtetit të së drejtës në dëm të tij, të cilat bënë që mjeti i brendshëm juridik kërkesa për revizion, i cili kishte qenë në dispozicion të tij, i paefektshëm në rastin e tij.”
33. Parashtruesi i kërkesës pretendon: “Në përputhje me këtë, roli i Gjykatës Kushtetuese në këto procese është të mos merret me gabimet që lidhen me ligjin që pretendohet se kanë bërë gjykatat vendase, përveç nëse dhe në masën në të cilën të njëjtat kanë çuar në shkeljen e nenit 13 të Konventa, për shkak të së cilës kërkesa për rishikimin e një vendimi penal të brendshëm në këtë çështje konkrete u bë e paefektshme, siç pretendon kërkuesi në ankimin kushtetues.”
34. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me kompetencën e Gjykatës për të vlerësuar konstatimet e gjykatave të rregullta, pretendon: “Në këto kushte, rrethanat në të cilat

Gjykata Kushtetuese do të ishte kompetente për të vënë në pikëpyetje gjetjet e deklaruara në aktvendimet e kundërshtuara të gjykatave kompetente duhet të tregojnë qartë faktin se gjetjet janë “në mënyrë flagrante dhe haptazi arbitrare”. Gjegjësisht, GJEDNJ, në Kononov kundër Letonisë” theksoi: Gjykata nuk mund të vë në dyshim vlerësimin e autoriteteve vendase nëse ai nuk është në mënyrë flagrante dhe haptazi arbitrar. Ky rregull i përgjithshëm, i cili fillimisht u formulua në lidhje me të drejtën për një gjykim të drejtë sipas nenit 6 § 1 të Konventës, zbatohet për të gjitha dispozitat thelbësore të Konventës.”

35. Parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme gabimisht ka interpretuar dispozitën procedurale të nenit 240.3 të LPK-së dhe pretendon: “Gjykata supreme, vendimin e saj në këtë pikë e ka arsyetuar duke u mbështetur nëni 240 paragrafi 3 të LPK-së, i cili thotë, citoj: “Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin aprovohet propozimi për përsëritjen e procedurës nuk lejohet ankimi.” Dispozita në fjale i referohet ankesës si mjet i rregullt juridik, por jo revizionit. Në këtë rast duhet të kuptojmë se neni 229 LPK-së, është rregullimi i një situatë përjashtuese dhe është superior në raport me nenin 240 të LPK-së. Është e qartë dhe evidente se këto shkelje kanë reflektuar edhe në ligjshmërinë e vendimit, për pasojë edhe në mohimin e të drejtave të garantuara për parashtruesin e kërkesës.”
36. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të konstatojë: (i) kërkesa të shpallet e pranueshme; (ii) të konstatohet shkelje e nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së; (iii) të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [E.rev.nr.4/2021] i datës 5 maj 2022 dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Dispozita relevante Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”

Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

“1.Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.”

[...]

Neni 13 (E drejta për zgjidhje efektive)

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

KTHIMI NË GJENDJEN E MËPARSHME

Neni 129 [Pa titull]

“129.1 Ne qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen.

129.2 Kur lejohet kthimi në gjendje të mëparshme procesi kontestimor kthehet në atë gjendje në të cilën ndodhej para mosveprimit dhe prishen të gjitha vendimet që i ka dhënë gjykata për shkak të mosveprimit.”

Neni 130 [Pa titull]

“130.1 Propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme i paraqitet gjykatës në të cilën është dashur të kryhet veprimi procedural i pakryer.

130.2 Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkakun e mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin.

130.3 Pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohej kthimi në gjendjen e mëparshme.

130.4 Po që se kthimi në gjendje të mëparshme kërkohej për shkak të mos ruajtjes së afatit për kryerjen e veprimit procedural, propozuesi ka për detyrë që propozimit t'ia bashkëngjisë veprimin e shkruar procedural të pakryer me kohë."

Neni 182 **[Pa titull]**

"182.1 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në çoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejtë ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjyqimit të ligjshëm e të drejtë.

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

- a) në çoftë se gjykata është përbërë jo sipas dispozitave ose në çoftë se në nxjerrjen e aktgjyqimit ka marrë pjesë gjyqtari që nuk ka marrë pjesë në seancën kryesore;
- b) në çoftë se është vendosur për kërkesën e cila nuk bënë pjesë në juridiksionin gjyqësor;
- c) në çoftë se në nxjerrjen e aktgjyqimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili sipas ligjit duhet të përjashtohet, respektivisht me vendim të gjykatës ka qenë i përjashtuar ose me rastin e dhënies se vendimit ka marrë pjesë personi i cili nuk e ka cilësinë e gjyqtarit;
- d) në çoftë se gjykata sipas prapsmit të palëve gabimisht ka vendosur se është e kompetencës lëndore;
- e) në çoftë se është vendosur për kërkesën sipas padisë të ngritur pas afatit të përcaktuar me ligj;
- f) në çoftë se gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është me kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë, gjykata e llojit tjetër;
- g) në çoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka bazuar vendimin e vetë në disponimin e palejueshëm të palëve, (neni 3 paragrafi 3 i këtij ligji);
- h) në çoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata ka nxjerr aktgjykim për shkak të pohimit, mosbindjes, mungesës, heqjes dorë nga kërkesëpadia, ose pa mbajtjen e shqyrtimit kryesor;
- i) në çoftë se ndonjëherë nga palët me veprimin e paligjshëm, e sidomos me mosdhënien e mundësisë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë;
- j) në çoftë se në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, gjykata e ka refuzuar kërkesën e palës, që në procedurë të përdorë gjuhën dhe shkrimin e vet e të ndjek procesin në gjuhën e vet, kurse për këtë arsye ankohet;

k) në qoftë se në procedurë si paditës, ose i paditur, ka marrë pjesë personi që nuk mund të jetë palë në procedurë, apo në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, ose në qoftë se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor ose në qoftë se përfaqësuesi ligjor, respektivisht përfaqësuesi me prokurë i palës nuk ka pasur autorizim të nevojshëm për zhvillimin e procedurës apo për kryerjen e ndonjë veprimi në procedurë, në qoftë se zhvillimi i procedurës, respektivisht ushtrimi i veprimeve të veçanta në procedurë nuk është lejuar më vonë;

l) në qoftë se është vendosur për kërkesën për të cilën vazhdon procedura apo për të cilën më parë është nxjerr aktgjykim i formës së prerë, ose prej të cilit paditësi njëherë ka hequr dorë ose për të cilin është lidhur pajtimi gjyqësor;

m) në qoftë se, në kundërshtim me ligjin është përjashtuar publiku në seancën kryesore;

n) në qoftë se aktgjykim i ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykim i nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;

o) në qoftë se me aktgjykim është tejkaluar kërkesëpadi.”

Neni 143 (Pa titull)

“143.1 Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore.

143.2 Në qoftë se me një padi janë përfshirë disa kërkesëpadi, gjykata, zakonisht vendosë për të gjitha me një aktgjykim të vetëm.

143.3 Në qoftë se gjykata i ka bashkuar disa procedime me qëllim të shqyrtimit të përbashkët të çështjeve, kurse për vendosje përfundimtare është pjekur vetëm njëra nga to, mund të jepet aktgjykim i vetëm për çështjen e tillë.”

Neni 229 (Pa titull)

“229.1 Revizioni është i lejueshëm kurdoherë kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin ankesa e paraqitur kundër vendimit përfundimtar hidhet poshtë përkatësisht me të cilin vërtetohet aktvendimi i shkallës së parë mbi hedhjen poshtë të revizionit të paraqitur kundër vendimit përfundimtar.

229.2 Revizioni është i lejueshëm edhe kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin është vendosur mbi propozimin për përsëritjen e procedurës.

229.3 Revizioni nuk lejohet kundër aktvendimit mbi shpenzimet procedurale.”

Neni 240 (Pa titull)

“240.3 Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin aprovohet propozimi për përsëritjen e procedurës nuk lejohet ankimi.”

PËRSËRITJA E PROCEDURËS

Neni 232 [Pa titull]

“Procedura e përfunduar me aktgjykim dhe aktvendim të formës së prerë të gjykatës mund të përsëritet sipas propozimit të palës:

[...]

g) në qoftë se pala merr dijeni për fakte të reja ose gjen prova të reja, ose e fiton mundësinë që t'i përdorë ato, në bazë të të cilave për palën do të mund të merrej vendim përfundimtar më i favorshëm, sikur faktet dhe provat e tilla të ishin përdorur në procedurën e mëparshme.”

Neni 234 [Pa titull]

“234.1 Propozimi për përsëritjen e procedurës paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, dhe atë:

a) në rastin nga neni 232, pika a) e këtij ligji, që nga dita kur palës i është dorëzuar vendimi i formës së prerë;

b) në rastin nga neni 232, pika b) e këtij ligji në qoftë se në procedurë si paditës apo si i paditur ka vepruar personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse nga dita në të cilën vendimi i është dorëzuar personit të tillë;

c) në qoftë se palën që është person juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, apo në qoftë se palën me pazotësi procedurale nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor i saj nga dita në të cilën vendimi i është dorëzuar palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor të saj, e po që se përfaqësuesi ligjor, gjegjësisht me prokurë i palës, nuk ka pasur autorizim të duhur për ndjekjen e çështjes në gjyq, apo për kryerjen e veprimeve procedurale të caktuara, nga dita kur pala ka marrë dijeni për këtë shkak ;

d) në rastin nga neni 232, pika c) e këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka marrë dijeni për aktgjykimin penal të formës së prerë;

e) në rastin nga neni 232, pika d) e këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka marrë dijeni për vendimin penal të formës së prerë, e nëse procedura penale nuk mund të zhvillohet, atëherë nga dita kur ka marrë dijeni për pezullimin e procedurës penale, apo për rrethanat për shkak të të cilave nuk mund të iniciohet procedura penale;

f) në rastet nga neni 232, pika e) dhe f) të këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka mundur ta përdorë vendimin e formës së prerë që është shkak për përsëritjes së procedurës;

g) në rastin nga neni 232, pika g) të këtij ligji – nga dita në të cilën pala ka mundur t'i parashtrojë në gjykatë faktet e reja, gjegjësisht mjetet provuese të reja.

234.2 Po që se afati i caktuar në paragrafin 1 të këtij neni do të fillonte të rrjedhë para së vendimi të ketë marrë formë të prerë, ky afat do të llogaritet nga momenti në të cilin vendimi bëhet i formës së prerë, në qoftë se kundër tij nuk është paraqitur ankesa, gjegjësisht nga dita e dorëzimit të vendimit të formës së prerë të gjykatës së lartë të dhënë në shkallë të fundit.

234.3 Pas kalimit të afatit prej pesë vjetësh nga dita kur vendimi bëhet i formës së prerë, propozimi për përsëritjen e procedurës nuk mund të paraqitet, përveçse kur përsëritja kërkohet nga shkaqet e përmendura në nenin 232, pika a dhe b të këtij ligji.”

Neni 235 **[Pa titull]**

“Mbi propozimin për përsëritjen e procedurës vendosë gjykata e shkallës së dytë, dhe atë gjyqtari individual i cili nuk ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të shkallës së dytë në procedurën e mëparshme.”

Neni 236 **[Pa titull]**

“236.1 Propozimi për përsëritjen e procedurës i paraqitet gjithmonë gjykatës që e ka dhënë vendimin e shkallës së parë.

236.2 Në propozim duhet treguar sidomos: baza ligjore në mbështetje të të cilës kërkohet përsëritja e procedurës, rrethanat nga të cilat rezulton se propozimi është paraqitur në afatin ligjor dhe mjetet provuese me të cilat arsyetohen thëniet e propozuesit.”

LIGJI Nr. 04/L-155 PËR SISTEMIN E PAGESAVE

Neni 33 **(Autorizimi i transfereve)**

“1. Një transfer i fondeve konsiderohet i autorizuar vetëm nëse dërguesi ka dhënë miratim për ekzekutimin e një transferi të tillë.

2. Miratimi për ekzekutimin e një transferi të fondeve apo të një serie të transfereve jepet në formën e dakorduar nga palët.

3. Në mungesë të një miratimi të tillë, transferi konsiderohet si i paautorizuar.

4. Nëse institucioni i pagesave dhe klienti i tij pajtohen se vërtetësia e urdhërpagesave të lëshuara për institucionin e pagesave në emër të klientit si dërgues do të verifikohen sipas procedurës së sigurisë, urdhërpagesa e pranuar nga institucioni pranues është po aq e vlefshme sikurse urdhri i klientit, pavarësisht se a është ose jo e autorizuar, nëse:

4.1. procedura e sigurisë është një metodë e arsyeshme në aspektin e tregut të ofrimit të sigurisë kundër urdhërpagesave të paautorizuara; dhe

4.2. institucioni dëshmon se e ka pranuar urdhërpagesën në mirëbesim dhe në pajtueshmëri me procedurën e sigurisë dhe ndonjë marrëveshje apo instruksion me shkrim nga ana e klientit që kufizon pranimin e urdhërpagesave të lëshuara në

emër të klientit. Institucioni nuk kërkohet që t'i përmbahet një udhëzimi që shkel marrëveshjen më shkrim me klientin apo njoftimi i të cilit nuk është pranuar në kohën dhe në mënyrën që institucionit i ofron mundësi të arsyeshme që të veprojë në të para pranimit të urdhërpagesës.”

LIGJI NR. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

Neni 9 (Ndalimi i shkaktimit të dëmit)

“Secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t'i shkaktoj dëm tjetrit.”

Neni 382 (Kamatëvonesa)

“1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën.

2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

37. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
38. Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*
- 7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
39. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.”*
40. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashikojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

*Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]*

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

*Neni 49
[Afatet]*

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

41. Në vlerësimin e përbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar se konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [E.Rev.nr.4/2021] të Gjykatës Supreme të 5 majit 2022, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
42. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e personit juridik ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës [KI41/09](#), parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).
43. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikon:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.
44. Gjykata rikujton që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së si dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme në bazë të dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin [KI04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin [KI175/20](#), parashtruese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
45. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë

- drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si “*pretendime qartazi të pabazuara*”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*”. (shih rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 27, si dhe rastin [KI175/20](#), cituar më lart, paragrafi 38).
46. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 28).
47. Gjykata vëren se esenca e këtij rasti ndërlidhet me padinë që parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur në Gjykatën Themelore kundër palës së paditur Banka “TEB” lidhur me mosmarrëveshjen për përgjegjësinë e pagesës së një shume të caktuar të të hollave në llogari të palës së tretë e cila nuk i kishte kthyer të hollat në fjalë. Gjykata Themelore e miratoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe urdhëroi palën e paditur bankën “TEB” që në afat prej shtatë ditësh nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm ta zbatoj vendimin e saj. Pala e paditur banka “TEB” paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit por kjo e fundit e refuzoi ankesën të paafatshme. Pala e paditur banka “TEB” paraqiti kërkesë për përsëritje të procedurës duke pretenduar se ankesa e saj ka qenë brenda afatit ligjor. Gjykata e Apelit e lejoi kërkesën për përsëritje të procedurës dhe konstatoi se ankesa fillestare e palës së paditur “TEB” ishte paraqitur brenda afatit ligjor dhe se ky fakt ishte vërtetuar edhe nga fletë-dërgesat në Postën e Kosovës. Gjykata e Apelit duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur banka “TEB” e refuzoi të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, shfuqizoi vendimin e Gjykatës Themelore që ishte në dobi të parashtruesit të kërkesës duke konstatuar se nuk mund të vërtetohej përgjegjësia e palës së paditur banka “TEB” lidhur me transferimin e gabuar të të hollave në llogarinë e palës së tretë. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme duke kontestuar në themelësi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit si dhe duke kundërshtuar vendimin për lejimin e përsëritjes së procedurës të propozuar nga pala e paditur banka “TEB”. Gjykata Supreme e refuzoi revizionin e parashtruesit të kërkesës lidhur me themelësinë e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe e hodhi të palejuar revizionin lidhur me vendimin e Gjykatës së Apelit për lejimin e përsëritjes së procedurës të propozuar nga pala e paditur banka “TEB”. Gjykata Supreme konstatoi se vet parashtruesi i kërkesës ishte përgjegjës për transferin e gabuar të të hollave në llogari të palës së tretë.
48. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës shprehimisht dhe në substancë ngre pretendime lidhur me nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së duke theksuar se revizioni i paraqitur në Gjykatën Supreme është mjet i paefektshëm juridik. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së e ndërlidh me pretendimin për zbatim të gabuar të ligjit nga Gjykata Supreme duke theksuar se në rastin e tij është dashur të zbatohet neni 229 i LPK-së dhe jo neni 240 i LPK-së, siç ka vepruar Gjykata Supreme.
49. Nga sa më sipër, duke marrë parasysh natyrën e kësaj kërkesë dhe pretendimeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata do të vlerësojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-

së si dhe do të vlerësojë nëse pretendimi për zbatim të gabuar të ligjit nga Gjykata Supreme, ngre çështje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

50. Në këtë drejtim, Gjykata vë në pah, konstatimet e Gjykatës së Apelit lidhur me lejimin e propozimit për përsëritje të procedurës dhe shqyrtimit në themelësi të ankesës së palës së paditur banka "TEB": (i) pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe në pajtim me dispozitat e nenit 239.1 të LPK-së propozimi për përsëritje të procedurës është i lejuar; (ii) propozimi për përsëritje të procedurës është paraqitur brenda afatit ligjor në pajtim me nenin 243.3 të LPK-së; (iii) pala e paditur ka dorëzuar dërgesën postare më 08.03.2019 çka dëshmohet edhe përmes Librit të pranimit të datës 08.03.2019, por pasi ka qenë fundi i orarit i zyrës postare dërgesa është vulosur të nesërmen në mëngjes me datë 09.03.2019; (iv) bazuar në konfirmimin zyrtar nga Posta e Kosovës rezulton se ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor prej shtatë (7) ditësh dhe nuk mund të konsiderohet më tutje si e paafatshme; (v) neni 32 i kushtetutës nënkupton të drejtën e secilit që të parashtojë ankesë ose mjete tjera juridike kundër akteve të veçanta juridike të nxjerra në procedurën në shkallë të parë gjykatës, organit të administratës ose organizatës dhe institucioneve të tjera që ushtrojnë autorizim publik; (vi) shfrytëzimi i mjeteve juridike është një mundësi e mirë që edhe njëherë autoritetet publike shtetërore t'i shqyrtojnë vendimet e tyre, t'i përmirësojnë gabimet ose lëshimet eventuale, që kanë mundur të ndodhin gjatë procedurave të ndryshme; (vii) në një gjendje të tillë të çështjes, pala propozuese nuk ka pasur mjet tjetër të efektshëm ligjor përveç mjetit juridik përsëritja e procedurës dhe për këto arsye miratohet propozimi duke lejuar që procedura e përfunduar me aktvendimin e formës se prerë të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.119/19 i datës 17.05.2019, të përsëritet dhe çështja në shqyrtim duhet që t'i dërgohet kolegjit që ankesa të trajtohet më tutje në përmbajtjen dhe themelësinë e saj; (viii) përsëritja e procedurës në këtë çështje mundëson parandalimin e padrejtësive, ofron vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj, rritë sigurinë juridike për palët dhe garanton parimin e sundimit të ligjit; (ix) nga sa u tha më sipër e bazuar në dispozitat e nenit 32 dhe 102 paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 234 paragrafi 1 pika g) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.
51. Gjykata po ashtu vë në pah konstatimet e Gjykatës Supreme: (i) Gjykata Supreme e hodhi të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [EN.n.7/19] të datës 21.10.2019, kjo për faktin se revizioni i është ushtruar kundër aktvendimit kundër të cilit nuk lejohet revizioni e as mjete i rregullt juridik, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 240.3 të LPK-së, ku përcaktohet "*Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin aprovohet propozimi për përsëritjen e procedurës nuk lejohet ankimi*"; (ii) po ashtu pretendimi në revizion lidhur me atë se ekziston përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit, për shkak të papërgjegjësisë së punëtorit të paditurës, është i pa bazë, nga akti i brendshëm i të paditurës, i quajtur Kushtet e Përgjithshme të paditurës, në nenin 6 par.2, me të cilën është përcaktuar: "*Është përgjegjësi e klientit të kontrolloje saktësinë e të gjithë numrave, detajeve dhe informatave mbi format dhe udhëzimet, përfshirë por jo kufizuar në transfere dhe formularë për taksa*"; (iii) andaj ky pretendim se punonjësi i të paditurës, nuk kishte vepruar sipas pro faturës nr. 04/14, dt. 20.01.2014, në emër të shitësit - pranuesit të mjeteve "M.T." Doo, është i pa bazë pasi vetë klienti është i detyruar që në rastin e nënshkrimit të urdhër transferit të kontrollojë të dhënat dhe saktësinë e tyre; (iv) Pro-fatura nr. 041/14, dt. 20.01.2014, në emër të shitësit-pranuesit të mjeteve "M.T." Doo, nuk përmban xhirologarinë në të cilin duhet të bëhet pagesa, ndërsa nga dëshmia mbi transaksionet e pagesave të parashtruesit të kërkesës, shihet se pagesa e fundit para transaksionit kontestues, është bërë me datë 23.12.2013, në llogarinë e firmës "L.M. Doo", që nënkupton se parashtruesi i kërkesës ka pasur transaksione dhe raporte afariste me të dy ndërmarrjet në emër të cilave është bërë

pagesa; (v) punonjësi i të paditurës e ka përmbushur obligimin e tij ndaj klientit me ofrimin për nënshkrim të urdhërpagesës, siç është i përkufizuar në nenin 33 par. 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 04/L-155 për sistemin e pagesave, ku është përcaktuar: “1.Një transfer i fondeve konsiderohet i autorizuar vetëm nëse dërguesi ka dhënë miratim për ekzekutimin e një transferi të tillë. 2. Miratimi për ekzekutimin e një transferi të fondeve apo të një serie të transfereve jepet në formën e dakorduar nga palët”; (vi) ndërsa nëse marrim parasysh nenin 6 par.2, të kushteve të përgjithshme të paditurës, në asnjë mënyrë nuk paraqet bazë për krijimin e detyrimit të paditurës në raport me parashtruesin e kërkesës;(vii) pretendimi se papërgjegjësia e të paditurës rezulton edhe me nenin 9 dhe 152, të LMD-së, është pretendim i pa bazuar, pasi në këtë rast punonjësi i të paditurës ka pasur detyrim që paditësit t’i shërbej si klient, sipas kërkesës së tij, duke e kryer shërbimin të cilin e kërkon, pra duke vepruar sipas kërkesës së tij, dhe me vet faktin se formulari i urdhërpagesës është dashur të plotësohet nga vet klienti, i njëjti bart edhe përgjegjësinë për pasaktësinë e të dhënave të shënuara; (viii) sa i përket ekzekutimit detyrimi i të paditurës është përmbushur me vet faktin se paditësi është njoftuar me kushtet e pagesës duke i ofruar për nënshkrim, dhe ky ka qenë sinjal i mjaftueshëm për paditësin që të ndaloj ekzekutimin e pagesës, pasi ka qenë detyrim i tij bëjë vërejtjet mbi pasaktësinë e urdhërpagesës; (ix) Gjykata Supreme vlerëson se ekspertiza e ekspertit financiar Sh.M., dhe grupit të ekspertëve në përbërje V.I., F.K., dhe R.F., nuk kanë asnjë rendësi për të vendosur në këtë çështje, ka qenë plotësisht e pa nevojshme të nxjerrët, për faktin se gjykata ekspertizën e cakton sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes, ndërsa në këtë rast nuk kemi të bëjmë fare me ekspertizë financiare, por përfundimet e këtyre ekspertizave janë konkluzione juridike për të cilat gjykata nuk ka pasur nevojë.

52. Nga sa më sipër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme por edhe Gjykata e Apelit: (i) kanë dhënë arsyet për lejimin e përsëritjes së procedurës duke shpjeguar aspektin faktik dhe provat që lejojnë përsëritjen e procedurës; (ii) kanë shpjeguar se lejimi i përsëritjes së procedurës dhe shqyrtimi në themelësi të ankesës së palës së paditur është në përputhje me nenin 32 të Kushtetutës lidhur me efektshmërinë e mjeteve juridike për palët ndërgjyqëse; (iii) kanë përcaktuar bazën ligjore dhe të njëjtën e kanë zbatuar ndaj fakteve të rastit të parashtruesit të kërkesës duke dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe logjike lidhur me përgjegjësinë e palëve në transferin bankar të të hollave sidomos kur ndodhin gabime, siç edhe ka ndodhur në rastin e parashtruesit të kërkesës.
53. Për sa i përket pretendimit për mungesë të mjetit efektiv juridik, Gjykata vëren se bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, autoritetet vendore që vendosin në një rast duhet të shqyrtojnë meritat e ankesës lidhur me të drejtat e garantuara me KEDNJ (shih rastet e GJEDNJ-së, [Smith dhe Grady kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 33985/96 33986/96, Aktgjykim i 25 korrikut 2000, paragrafi 138; [Peck kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 44647/98, Aktgjykim i 28 janarit 2003, paragrafët 105-106). Mjeti duhet t’i përfshijë meritat e ankesës siç janë parashtruar nga ankuesi. Nëse autoriteti ose gjykata vendore në fjalë e riformulon ankesën ose dështon që të marrë parasysh ndonjë element thelbësor të shkëljes së pretenduar të KEDNJ-së, atëherë mjeti do të jetë i pamjaftueshëm (shih rastin e GJEDNJ-së, [Glas Nadezhda EOOD dhe Elenkov kundër Bullgarisë](#), nr. 14134/02, Aktgjykim i 11 tetorit 2007, paragrafi 69).
54. Bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së “efektshmëria” e një mjeti për qëllime të nenit 13 të KEDNJ-së nuk varet nga siguri i rezultatit të favorshëm për ankuesin (shih rastet e GJEDNJ-së, [Swedish Engine Drivers’ Union kundër Suedisë](#), nr. 5614/72, Aktgjykim i 6 shkurtit 1976, paragrafi 50; [Kudła kundër Polonisë](#), nr. 30210/96, Aktgjykim i 26 tetorit 2000, paragrafi 157) Fjala mjet në kontekst të nenit 13 nuk nënkupton mjet që do të jetë i suksesshëm, por thjeshtë një mjet të qasshëm pranë autoritetit kompetent që do t’i shqyrtojë meritat e ankesës (shih rastin e GJEDNJ-së,

C. kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 11882/85, Vendim për pranueshmëri i 7 tetorit 1987). Neni 13 garanton pasjen e mjetit në dispozicion por jo edhe rezultat të suksesshëm (shih rastin e GJEDNJ-së, R. kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 12039, Vendim për pranueshmëri i 18 korrikut 1986).

55. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme dhe Gjykata e Apelit në kombinim kanë përmbushur kushtin e mjetit efektiv juridik siç kuptohet me nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së sepse çështja e përgjegjësisë për transferin e gabuar të të hollave dhe çështja e lejimit të përsëritjes së procedurës janë shqyrtuar në merita, çka është në përputhje me ofrimin e mjetit efektiv juridik. Fakti se rezultati i rastit nuk është në dobi të parashtruesit të kërkesës në vetvete nuk ngre çështje të nenit 32 të Kushtetutës në kombinim me nenin 13 të KEDNJ-së.
56. Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për mjet juridik efektiv siç garantohet me nenin 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, janë pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” dhe duhet të refuzohen qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç specifikohet në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.
57. Sa i përket pretendimeve për zbatim të gabuar të ligjit nga Gjykata Supreme, Gjykata ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së García Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës KI128/18 parashtrues *Limak Kosovo International Airport Sh.A. “Adem Jashari”*, Aktvendim për Papranueshmëri i 27 majit 2019, paragrafi 56; dhe KI62/19 parashtrues *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 nëntorit 2019, paragrafi 58).
58. Sërish lidhur me pretendimin për zbatim të gabuar të ligjit, Gjykata përsëritë se sa i përket gjyqësorit të rregullt, Gjykata Supreme është autoriteti më i lartë gjyqësor në Republikën e Kosovës (shih neni 103.2 i Kushtetutës) dhe se interpretimi i saj i dispozitave përkatëse ligjore dhe çështjeve tjera të ligjit mbizotëron ndaj interpretimeve ligjore të gjykatave të instancës më të ulët si dhe ndaj vet palëve ndërgjyqëse. Në rastin konkret, vlerësimi dhe interpretimi i dispozitave ligjore nuk ngre çështje të garancive procedurale nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 (1) i KEDNJ-së (shih rastin e Gjykatës KI37/21 parashtrues *Isa Tusha, Naser Tusha dhe Miradije Tusha*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 shtatorit 2021, paragrafi 65 dhe referencat e përmendura aty).
59. Duke vlerësuar procedurat e zhvilluara në tërësi në gjykatat e rregullta, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës përfitoi nga procedura kontradiktore dhe se ai ishte në gjendje të paraqes në faza të ndryshme të procedurës pretendimet dhe provat që ai i konsideroi të rëndësishme për rastin e tij; ai ka pasur mundësinë të hedhë poshtë në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtarë; gjykatat e rregullta dëgjuan dhe shqyrtuan të gjitha pretendimet e tij, të cilat, shikuar objektivisht, ishin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit; arsyet faktike dhe ligjore për vendimin e kontestuar janë dhënë në hollësi dhe procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, García Ruiz kundër Spanjës, cituar më lart, paragrafët 29 dhe 30, shih gjithashtu rastin e Gjykatës nr.

KI22/19, parashtres *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).

60. Gjykata konkludon se pretendimet e parashtresit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohen me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me dhe nenin 6 (1) të KEDNJ-së, janë pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” dhe duhet të refuzohen qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç specifikohet në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 59 (2) të Rregullores së punës, më 12 prill 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtare raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani